

Për:	“SIGKOS” Sh.a. me adresë në Prishtinë
Nga:	Jetulla Kabashi – Menaxher i Prokurimit – Komuna e Rahovecit
Lënda:	VENDIM i Kërkesën për rishqyrtim të datës: 02/07/2018
Datë:	03/07/2018

I nderuar z. Shpend Shala – Drejtor,

Autoriteti Kontraktues Komuna e Rahovecit ka pranuar kërkesën për rishqyrtim të datës: 02/07/2018, të pranuar formë elektronike përmesë e-mail adrese: prokurimi.rahovec@gmail.com, nga OE: “SIGKOS” Sh.a. me adresë në Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit: **Sigurimi i Automjeteve të Komunës së Rahovecit**, me Numër të prokurimit: **623-18-3759-2-2-1**, Numri i brendshëm: **623-18-030-2-2-1**, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues: (AK) – **Komuna e Rahovecit**.

Kërkesa është REFUZUAR si e pa bazë konform nenit 108/A pika 8.4 të LPP-së.

- Arësytim:

Pas kërkesës tuaj dhe pretendimeve se janë shkelur nenet:

Neni 7 – Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi,

Neni 59 – Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahassimi i Tenderëve,

Neni 60 – Kriteri për Dhënien e Kontratës.

Ne analizuam edhe njëherë vendimin e marrë me datë: 28.06.2018, për dhënie të kontratës O.E. KS “KOSOVA E RE” SH. A. – Prishtinë, të rekomanduar nga Komisioni vlerësues.

A.K. Komuna e Rahovecit gjatë Ekzaminimit, vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve, komisioni ka vlerësuar të gjitha tenderët në mënyrë të barabartë dhe jo diskriminues gjë që është respektuar neni. 7 i LPP – së.

Sa i përket nenit 59. Autoriteti Kontraktues nuk ka mundur që këtë O.E. ta klasifikoj si të papërgjegjshëm sepse ka qenë në përputhje me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe dosjes së tenderit, d.m.th. neni 59 është respektuar.

Neni 60. Është respektuar sespe A.K. i ka dhënë kontrat publike O.E. që ka dorëzuar tenderin e përgjegjshëm me çmimin më të ulët.

Ankesa juaj është e pa bazuar për shkak se te pretendimi juaj është:

- | |
|--|
| <ol style="list-style-type: none"> 1. Tek specifikacioni i automjeteve të Komunës së Rahovecit, tek vetura mini bus Toyota Coaster Bus-Nder Urbane operatori fitues ka ofertuar me tarifa urban me prime 509.76€ e qe duhet te jete 708.00€ sipas tarifave të BQK Nder Urbane, dhe Autobus Mercedes Benz 0303-13 R – Nder Urbane - operatori fitues Kosova e Re ka ofertua me prime urban 549.88€ e qe duhet te jete 808.30€ sipas tarifave të BQK Nder Urbane. 2. Kompania e sigurimeve Kosova e Re e shpallur fitues nuk i është përmbajtur tarifave të BQK. 3. Prandaj, mbi bazën e kësaj i propozojmë Autoritetit kontraktues qe kjo lende te shkoj ne rivlerësim para se operatori ekonomik te parashtroj anekese ne OSHP. |
|--|

Ne si Autoriteti Kontraktues e kemi shpallur fitues: O.E. KS "KOSOVA E RE" SH. A. - Prishtinë, bazuar në LPP dhe kërkesave në Dosjen e Tenderit si tenderues teknikisht i përgjegjshëm dhe me çmim më të ulët.

O.E. KS "KOSOVA E RE" SH. A. - Prishtinë, do të jetë i obliguar të respektoj çmimet me të cilat ka ofertuar.

Kjo procedurë është trajtuar konform Ligjit Nr. 04/042, Ligji për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-92.

-Kundër këtij **vendimi të AK ju munde të paraqitni** ankesë pranë OSHP-së në pajtim me nenin 109 të LPP-së.

Me respekt

Jetulla Kabashi

Shef i Zyres së Prokurimit – Komuna e Rahovecit.
